



# FLETORJA ZYRTARE

## E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 93

2003

Nëntor

### P Ë R M B A J T J A

|                                       | Faqe                                                                                                                                                                                                                                |
|---------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Ligj nr.9145,<br>datë 30.10.2003      | Për ratifikimin e “Marrëveshjes së kredisë të zhvillimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës ndërkombëtare për zhvillim (IDA), për programin e fazës së dytë të kredisë, në mbështetje të uljes së varfërisë”..... 4127 |
| Ligj nr.9146,<br>datë 30.10.2003      | Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqatës ndërkombëtare për zhvillim (IDA), për ndryshimin e Marrëveshjes së kredisë të zhvillimit, për projektin e mirëmbajtjes së rrugëve”..... 4133         |
| Vendim i KM<br>nr.743, datë 6.11.2003 | Për disa ndryshime në vendimin nr.159, datë 13.3.2003 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet, si dhe procedura e shitjes"..... 4138                                             |
|                                       | <i>Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Qemal Xhelal Veizi</i> ..... 4138                                                                                                                                                  |

**L I G J**  
**Nr.9145, datë 30.10.2003**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË KREDISË TË ZHVILLIMIT, NDËRMJET  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM  
(IDA), PËR PROGRAMIN E FAZËS SË DYTË TË KREDISË, NË MBËSHTETJE TË ULJES  
SË VARFËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e kredisë së zhvillimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për programin e fazës së dytë të kredisë, në mbështetje të uljes së varfërisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.4000, datë 7.11.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Alfred Moisiu**

**MARRËVESHJE**

**E KREDISË PËR ZHVILLIM (KREDIA E DYTË NË MBËSHTETJE TË ULJES SË VARFËRISË)  
NDËRMJET SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM**

Marrëveshje bërë në datën 24 korrik 2003 ndërmjet SHQIPËRISË (Huamarrësi) dhe SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (Shoqata).

Meqë: A) Shoqata ka marrë nga Huamarrësi një letër të datës 12 maj 2003, që përshkruan programin e veprimeve, objektivave dhe politikave, me qëllim zbutjen e varfërisë në territorin e Huamarrësit (tani e tutje quhet programi), që deklaron angazhimin e Huamarrësit për zbatimin e programit dhe përmban kërkesën për asistencë nga Shoqata për të mbështetur programin gjatë zbatimit.

B) Huamarrësi ka realizuar masat dhe ka ndërmarrë veprimet të përshkuara në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje të pëlqyeshme për Shoqatën.

C) Në bazë, ndër të tjera, të pohimeve të mësipërme, Shoqata ka vendosur të mbështesë programin duke siguruar asistencë për Huamarrësin duke dhënë kredinë siç përshkruhet në vijim, prandaj, Palët bien dakord për sa vijon:

Neni 1

**Kushtet e përgjithshme, përkufizimet**

Seksioni 1.01 "Kushtet e përgjithshme për t'u zbatuar në Marrëveshjet e kredisë për zhvillim" të Shoqatës, nënshkruar më datë 1 janar 1985 (ndryshuar në 6 tetor 1999) me ndryshimet e përcaktuara

më poshtë (Kushtet e përgjithshme), përbëjnë pjesën integrale të kësaj Marrëveshjeje.

a) Seksioni 2.01 paragrafi 12 ndryshohet për t'u lexuar;

"Projekt" do të thotë programi, referuar hyrjes së Marrëveshjes së kredisë së zhvillimit në mbështetje të së cilës jepet kredia.

b) Seksioni 4.01 ndryshohet për t'u lexuar:

"Përveçse kur Huamarrësi dhe Shoqata bien dakord ndryshe, tërheqjet nga llogaria e kredisë do të bëhen në monedhën e llogarisë së depozitës të përcaktuar në seksionin 2.02 të Marrëveshjes së kredisë së zhvillimit".

c) Seksioni 5.01 ndryshohet për t'u lexuar:

"Huamarrësi ka të drejtën të tërheqë shumat e kredisë nga llogaria e kredisë, në përputhje me kushtet e Marrëveshjes së kredisë të zhvillimit dhe ato të kushteve të përgjithshme".

d) Fjalja e fundit e seksionit 5.03 anulohet.

e) Seksioni 9.06 (c) ndryshohet për t'u lexuar:

" (c) Jo më vonë se 6 muaj pas datës së mbylljes ose në ndonjë datë të mëvonshme siç mund të bihet dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Shoqatës, Huamarrësi do të përgatisë dhe do t'i japë Shoqatës një raport për këtë qëllim dhe detaje si t'i kërkojë Shoqata, për zbatimin e programit referuar hyrjes së Marrëveshjes së kredisë të zhvillimit, arritjet e Huamarrësit dhe Shoqatës, lidhur me detyrimet e tyre përkatëse sipas Marrëveshjes së kredisë të zhvillimit dhe për përmbushjen e qëllimeve të kredisë".

(f) Seksioni 9.04 anulohet dhe seksionet 9.05, 9.06 (të ndryshuara më sipër), 9.07 dhe 9.08 do të numërohen përsëri, respektivisht, seksionet 9.04, 9.05, 9.06 dhe 9.07.

Seksioni 1.02 Përveç rasteve kur konteksti kërkon ndryshe, disa terma të përcaktuara në kushtet e përgjithshme dhe në hyrje të kësaj Marrëveshjeje kanë kuptimet përkatëse të përcaktuara këtu më poshtë dhe termat plotësuese që pasojnë kanë kuptimet e mëposhtme:

a) "Banka e Shqipërisë" do të thotë banka qendrore e Huamarrësit.

b) "Llogaria e depozitës" do të thotë llogaria referuar seksionit 2.02 (b) të kësaj Marrëveshjeje.

c) "VF" do të thotë viti fiskal i Huamarrësit që fillon në 1 janar dhe mbaron në 31 dhjetor të çdo viti.

d) "Letra e politikave të zhvillimit" do të thotë letra e Huamarrësit që i referohet paragrafit (A) të hyrjes së kësaj Marrëveshjeje.

e) "PBA" do të thotë kuadri afatmesëm i shpenzimeve për Buxhetin e Shtetit dhe buxheti i çdo fondi shtetëror jobuxhetor, së bashku me detajet e investimeve kryesore dhe projekteve të tjera, të pranuar nga Huamarrësi.

f) "SKZHES" do të thotë strategjia kombëtare për zhvillimin ekonomik dhe social të Huamarrësit.

## Neni 2

### Kredia

Seksioni 2.01 Shoqata pranon t'i japë Huamarrësit, sipas kushteve dhe termave të përcaktuara ose të përmendura në Marrëveshjen e kredisë për zhvillim, një shumë në valuta të ndryshme baras me ekuivalentin prej trembëdhjetë milionë e njëqind mijë të drejta të posaçme tërheqëse (SDR 13 100 000).

Seksioni 2.02 a) Sipas kushteve të paragrafëve (b), (c) dhe (d) të këtij seksioni, Huamarrësi ka të drejtën të tërheqë shumat e kredisë nga llogaria e kredisë që mbështet programin.

b) Huamarrësi, përpara se të dërgojë te Shoqata kërkesën e parë për tërheqje nga llogaria e kredisë, do të hapë dhe do të mbajë një llogari depozite speciale në dollarë në bankën e tij qendrore me kushte dhe terma të pranueshme për Shoqatën. Të gjitha tërheqjet nga llogaria e kredisë do të depozitohen nga Shoqata në llogarinë e depozitës.

c) Huamarrësi merr përsipër se nuk do të përdorë shumat e kredisë për të financuar shpenzimet e përjashtuara sipas kushteve të shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje. Nëse Shoqata përcakton në çdo kohë se ndonjë shumë e kredisë është përdorur për të paguar shpenzime të përjashtuara, menjëherë pas njoftimit nga ana Shoqatës, Huamarrësi do të (i) depozitojë në llogarinë e depozitës një shumë të barabartë me shumën e pagesës së sipërpërmendur ose, (ii) nëse Shoqata do të kërkojë të

kompensojë Shoqatën me këtë shumë. Shumat, që i kompensohen Shoqatës me kërkesë, do të kreditohen në llogarinë e kredisë për anulim.

Seksioni 2.03. Data e mbylljes është 31 dhjetor 2004 ose një datë e mëvonshme e përcaktuar nga Shoqata. Shoqata menjëherë do të njoftojë Huamarrësin lidhur me datën e mëvonshme.

Seksioni 2.04. a) Huamarrësi do t'i paguajë Shoqatës një tarifë angazhimi mbi shumën principale të kredisë së pa tërhequr nga koha në kohë me një përqindje të caktuar nga Shoqata duke filluar me 30 qershor të çdo viti, por duke mos tejkaluar vlerën e një gjysmë përqindëshi (1/2 tel %) në vit.

b) Tarifa e magazinimit lind: (i) gjashtëdhjetë ditë nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje (data rrjedhëse) deri në datat respektive në të cilat shumat do të tërhiqen nga Huamarrësi nga llogaria e kredisë ose do të anulohen dhe (ii) në përqindjen e caktuar më 30 qershor menjëherë para datës rrjedhëse ose me një interes tjetër që pastaj mund të përcaktohet nga koha në kohë, në përputhje me paragrafin mësipër. Interesi i caktuar më 30 qershor në çdo vit do të aplikohet nga data tjetër e të njëjtit vit të specifikuar në seksionin 2.06 të kësaj Marrëveshjeje.

c) Pagesa e tarifës së angazhimit do të kryhet: (i) në vende të tilla që Shoqata në mënyrë të arsyeshme do të kërkojë; (ii) pa kufizime të çfarëdolloji që mund të imponohen nga, ose në territorin e Huamarrësit; (iii) në monedhë, të përcaktuar në këtë Marrëveshjeje për qëllimet e seksionit 4.02 të kushteve të përgjithshme ose në monedha të tjera të pranueshme që nga koha në kohë mund të përcaktohen ose të zgjidhen në përputhje me dispozitat e këtij seksioni.

Seksioni 2.05 Huamarrësi do t'i paguajë Shoqatës një tarifë shërbimi me një përqindje prej tre të katërtave të një përqindëshit (3/4 e 1%) në vit të shumës principale të kredisë së tërhequr dhe të papaguar nga koha në kohë.

Seksioni 2.06 Tarifat e angazhimit dhe të shërbimit do të paguheshin dy herë në vit më 15 prill dhe 15 tetor të çdo viti për qëllimet e shlyerjes.

Seksioni 2.07 (a) Huamarrësi do të shlyejë shumën principale të kredisë në këstet 6 mujore çdo 15 prill dhe 15 tetor duke filluar nga 15 tetori 2003 dhe duke përfunduar me 15 prill 2023. Çdo këst duhet të jetë 5 për qind (5%) e shumës principale.

Seksioni 2.08 Monedha e Shteteve të Bashkuara të Amerikës caktohet si monedhë e përdorshme për qëllimet e seksionit 4.02 të kushteve të përgjithshme.

### Neni 3

#### **Kushte të veçanta**

Seksioni 3.01 a) Huamarrësi dhe Shoqata nga koha në kohë me kërkesë të secilës Palë, do të shkëmbejnë mendime mbi progresin e arritur nga zbatimi i programit.

b) Përpara çdo shkëmbimi mendimesh, Huamarrësi do t'i japë Shoqatës për të rishikuar dhe për të dhënë komente një raport mbi progresin e arritur nga zbatimi i programit, i detajuar siç mund ta kërkojë Shoqata.

c) Pa kufizime sipas kushteve të paragrafit (a) të këtij seksioni, Huamarrësi do të shkëmbejë mendimet me Shoqatën mbi çdo veprim të propozuar për t'u ndërmarrë pas disbursimit të kredisë, që do të ndikonte në ndryshimin e objektivave të programit ose mbi çdo veprim të ndërmarrë sipas programit.

Seksioni 3.02 Me kërkesë të Shoqatës, Huamarrësi:

a) do të auditojë llogarinë e depozitës në përputhje me principet e përshtatshme audituese, të zbatueshme nga auditorët të pavarur, të pranueshëm për Shoqatën;

(b) do t'i japë Shoqatës sa më shpejt, por në çdo rast jo më vonë se katër muaj pas datës së kërkesës së Shoqatës për një auditim të tillë, një kopje të vërtetuar të raportit të auditimit nga auditorët e përmendur për këtë qëllim dhe i detajuar, si ta kërkojë Shoqata;

c) do t'i japë Shoqatës informacion tjetër, lidhur me llogarinë e depozitave dhe auditimin, si ta kërkojë Shoqata.

Neni 4  
**Ngjarje shtesë për pezullimin**

Seksioni 4.01 Sipas seksionit 6.02 (1) të kushteve të përgjithshme ngjarje shtesë do të quhet kur një situatë është shfaqur, dhe që e bën të pamundur zbatimin e programit ose të një pjese të rëndësishme të programit.

Neni 5  
**Përfundimi**

Seksioni 5.01 Nëntëdhjetë ditë (90) pas datës së kësaj Marrëveshjeje përcaktohet për qëllimet e seksionit 12.04 të kushteve të përgjithshme.

Neni 6  
**Përfaqësuesi i Huamarrësit; adresat**

Seksioni 6.01 Ministri i Financave i Huamarrësit caktohet si përfaqësues i Huamarrësit për qëllimet e seksionit 11.03 të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 6.02 Adresat e mëposhtme janë përcaktuar për qëllimet e seksionit 11.01 të kushteve të përgjithshme.

|                                |                                       |
|--------------------------------|---------------------------------------|
| Për Huamarrësin:               | Për Shoqatën:                         |
| Ministria e Financave          | International Development Association |
| Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" | 1818 H Street, N.W.                   |
| Tiranë                         | Washington, D.C. 20433                |
| Albania                        | United States of America              |
| Faks:                          | Adresa telegrafike                    |
| 35542 28495                    | INDEVAS                               |
|                                | Washington, D.C.                      |
|                                | Teleks                                |
|                                | 248423 (MCI) ose (202) 477-6391       |
|                                | 64145 (MCI)                           |

Para dëshmitarëve, palët nënshkruese, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë rënë dakord që kjo Marrëveshje të nënshkruhet me emrat e tyre përkatës në Tiranë, Shqipëri, në datën dhe vitin e lartshënuar për herë të parë.

SHTOJCA 1  
**SHPENZIMET E PËRJASHTUARA**

Për qëllimet e seksionit 2.02 (c) të kësaj Marrëveshjeje, shumat e kredisë nuk do të përdoren për financimin e shpenzimeve të mëposhtme:

1. Shpenzime në monedhën e Huamarrësit ose mallrave dhe shërbimet të furnizuara nga territori i Huamarrësit.

2. Shpenzime për mallra ose shërbime, të furnizuara sipas një kontrate të financuar nga ndonjë institucion financiar kombëtar ose ndërkombëtar, ose agjenci të ndryshme nga banka ose Shoqata, ose për të cilën Shoqata ose banka kanë financuar ose kanë rënë dakord për të financuar një kredi ose hua tjetër.

3. Shpenzime për mallrat të përfshira në grupet ose nëngrupet e mëposhtme të klasifikimit standard të tregtisë ndërkombëtare, rishikimi 3 (SITC Rish,3), të publikuara nga statistikat e Kombeve të Bashkuara, seritë M, Nr. 34/rish 3 (1986) (SITC) ose në çdo grup ose nëngrup pasues sipas rishikimeve të ardhshme të SITC, të përcaktuara nga Shoqata dhe të njoftuara Huamarrësit:

|       |          |                                             |
|-------|----------|---------------------------------------------|
| Grupi | Nëngrupi | Përshkrimi                                  |
| 112   | --       | Pije alkoolike                              |
| 121   | --       | Tobako, të pafabrikuara tobako të refuzuara |

|     |        |                                                                                                                                            |
|-----|--------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 122 | --     | Tobako të fabrikuar<br>(që përmbajnë ose jo zëvendësues të tobakos)                                                                        |
| 525 | --     | Materiale radioaktive dhe të ngjashme                                                                                                      |
| 667 | --     | Gurë të çmuar, perla dhe gjysmë të çmuara, të papunuara ose të punuara                                                                     |
| 718 | 718.7  | Reaktorë nuklearë dhe pjesë të tyre, elemente djegëse, jorrezatuese për reaktorët nuklearë                                                 |
| 728 | 728.43 | Makineri të përpunimit të tobakos                                                                                                          |
| 897 | 897.3  | Bizhuteri prej floriri, metale prej argjendi ose platinë (përveç orëve dhe kutive të orëve) dhe mallrave të arpunuesve dhe argjendpunuesve |
| 971 | --     | Ar, jomonetarë (duke përfshirë mineralet prej floriri dhe përqëndrimet)                                                                    |

4. Shpenzime për mallra për qëllimet ushtarake ose paraushtarake ose për konsumin e mallrave luksoze.

5. Shpenzimet për mallrat e rrezikshme për mjedisin (për qëllimet të këtij paragrafi termi "mallra të rrezikshme për mjedisin" do të thotë mallra, prodhimi, përdorimi ose importimi i të cilave është i ndaluar sipas ligjeve të Huamarrësit ose marrëveshjeve ndërkombëtare, pjesë e të cilave është edhe Huamarrësi.

6. Shpenzime (a) në territoret e çdo vendi që nuk është anëtar i Bankës ose për mallrat e prokuruar në, ose shërbimet e furnizuara nga territore të tilla ose (b) në llogaritë e pagesave për personat ose njësi, ose çdo importim i mallrave, nëse pagesa ose importe të tilla janë të ndaluara me anë të një vendimi të Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara sipas kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

7. Shpenzime sipas një kontrate lidhur me të cilën Shoqata përcakton se janë përdorur praktika korruptuese ose mashtruese, nga përfaqësuesit e Huamarrësit ose nga një përfitues i kredisë gjatë prokurimit ose zbatimit të kësaj kontrate, pa u marrë masat kundërvepruese të duhura dhe në kohën e përshtatshme nga ana e Huamarrësit dhe të pëlqyeshme për Shoqatën.

## SHTOJCA 2 PROGRAMI I VEPRIMEVE TË NDËRMARRA NGA HUAMARRËSI

1. Huamarrësi të ketë ruajtur një kuadër makroekonomik të pëlqyeshëm.

2. Huamarrësi të ketë një progres të pëlqyeshëm në zbatimin e rekomandimeve të studimit mbi pengesat administrative nëpërmjet një task force ndërminstrore të drejtuar nga Ministri i Ekonomisë.

3. Huamarrësi të ketë dërguar:

a) raportin e progresit të parë të SKZHES dhe planin e veprimeve;

b) planet e monitorimit të SKZHES për 12 ministritë përkatëse të renditura në urdhrin e Kryeministrit nr.251, datë 23 shtator 2002, që përcakton objektivat, indikatorët, realizimet dhe burimet e verifikimit.

4. Huamarrësi të ketë rritur buxhetin për shëndetin publik për vitin fiskal 2003, që të jetë në përputhje me PBA-në dhe bazuar në një plan menaxhimi të kënaqshëm të burimeve njerëzore dhe analizën e kostove aktuale të lehtësirave shëndetësore.

5. Huamarrësi të ketë:

a) siguruar se komunat dhe bashkitë së bashku kanë një buxhet të mjaftueshëm për trimestrat e dyta dhe të treta të vitit fiskal 2003;

b) alokuar fonde shtesë për shpenzimet e mirëmbajtjes dhe të veprimeve prioritare në shëndetin publik dhe parësor për vitin fiskal 2003.

6. Huamarrësi të ketë pasur një progres të kënaqshëm në zbatimin e masave për të fuqizuar

shpërndarjen e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor dhe publik.

7. Huamarrësi të ketë rritur buxhetin për sektorin e arsimit për vitin fiskal 2003 në përputhje me PBA-në.

8. Huamarrësi të ketë rënë dakord për të përgatitur një letër politike që përcakton përgjegjësitë aktuale të pushtetit vendor dhe qendror, lidhur me arsimin parauniversitar në një mënyrë të pëlqyeshme për Shoqatën.

9. Huamarrësi të ketë miratuar një politikë të librave shkollorë të pëlqyeshme për Shoqatën.

10. Të ketë hyrë në fuqi ligji mbi uljen e përfitimeve për pensionin e parakohshëm.

11. Huamarrësi të ketë siguruar një evidencë të pëlqyeshme të veprimeve të personelit, lidhur me caktimet ose pezullimet e personelit në pozicione kyçe të Huamarrësit, të cilat janë në përputhje me objektivat e legjislacionit përkatës, si dhe me principet e draft-kodit të etikës siç është rënë dakord me Shoqatën dhe t'i dërgohet Kuvendit.

12. Të ketë hyrë në fuqi ligji mbi deklarimin e pasurisë së Huamarrësit dhe të jetë caktuar inspektori i lartë i përgjithshëm.

13. Të ketë hyrë në fuqi ligji mbi auditin e brendshëm dhe Huamarrësi të ketë progres të kënaqshëm në zbatimin e tij.

14. Huamarrësi të ketë caktuar procedurat për thesarin qendror për rakordimin ditor të të dhënave të pagesave të marra nga degët e thesarit nëpër rrethe me të dhënat e rimbursimeve të marra nga Banka e Shqipërisë.

15. Të ketë hyrë në fuqi nga Huamarrësi ligji mbi prokurimin publik.

## **L I G J**

**Nr.9146, datë 30.10.2003**

### **PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA), PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES SË KREDISË TË ZHVILLIMIT, PËR PROJEKTIN E MIRËMBAJTJES SË RRUGËVE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

## **K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

## Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për ndryshimin e marrëveshjes së kredisë të zhvillimit, për projektin e mirëmbajtjes së rrugëve".

## Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.4001, datë 7.11.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Alfred Moisiu**

### MARRËVESHJE

#### PËR AMENDIMIN E MARRËVESHJES SË KREDISË TË ZHVILLIMIT

Marrëveshje, bërë në datën 24 korrik 2003, ndërmjet Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Zhvillimit (Shoqata).

Ndërkohë (A) Huamarrësi dhe Shoqata kanë hyrë në një Marrëveshje për kredi zhvillimi (projekti i mirëmbajtjes së rrugëve), në datën 15 qershor 2002 (Marrëveshja e kredisë së zhvillimit), me qëllim sigurimin e mbështetjes gjatë zbatimit të projektit të mirëmbajtjes së rrugëve, siç përshkruhet në pjesën A të Marrëveshjes së kredisë të zhvillimit (projekti);

(B) Huamarrësi ka kërkuar që Shoqata të sigurojë asistencë të mëtijshme në mbështetje të projektit, duke rritur shumën e vënë në dispozicion sipas Marrëveshjes së kredisë të zhvillimit në njëzet e tre milionë në valuta të ndryshme me të drejtë të veçantë tërheqjeje (SDR 23 000 000) dhe

ndërkohë shoqata ka rënë dakord, mbi bazën e lartpërmendur, midis të tjerave t'i sigurojë një asistencë të tillë shtesë Huadhënësit sipas afateve dhe kushteve të parashtruara në këtë Marrëveshje, si rrjedhim tani Palët bien dakord për këtë si më poshtë:

## Neni 1

### Amendamente të Marrëveshjes së kredisë të zhvillimit

Seksioni 1.01 Seksioni 1.02 i Marrëveshjes së kredisë të zhvillimit është ndryshuar duke hequr lidhëzën "dhe" në fund të nënseksionit (g), duke zëvendësuar; "dhe" me " ." në fund të nënseksionit (h) dhe duke shtuar një nënseksion të ri (i) si më poshtë:

"(i)"Marrëveshje amendimi" nënkupton marrëveshjen që amendon Marrëveshjen e kredisë së zhvillimit (projekti i mirëmbajtjes së rrugëve) ndërmjet Huamarrësit dhe Shoqatës të datës 15 korrik 2002".

Seksioni 1.02 Seksioni 2.01 i Marrëveshjes së kredisë së zhvillimit ndryshohet për t'u lexuar:

"Seksioni 2.01 Shoqata bie dakord t'i japë Huamarrësit, sipas afateve dhe kushteve të parashtruara ose të referuara në Marrëveshjen e kredisë së zhvillimit, një sasi fondesh në valuta të ndryshme prej njëzet e tre milionë me të drejtë të veçantë tërheqjeje (SDR 23 000 000) (kredia), e cila përfshin: (a) një shumë fillestare në valuta të ndryshme prej trembëdhjetë milionë e pesëqind mijë të drejta të veçanta tërheqjeje (SDR 13 500 000) (financimi fillestar) dhe (b) një shumë shtesë në valuta të ndryshme prej nëntë milionë e pesëqind mijë të drejta të veçanta tërheqjeje (SDR 9 500 000) (financimi shtesë)."

Seksioni 1.03 Seksioni 2.02 (b) i Marrëveshjes së Kredisë të Zhvillimit është ndryshuar për t'u lexuar si më poshtë:

"Seksioni 2.02(b) Huamarrësi, për qëllime të projektit, mund të hapë dhe të ruajë në dollarë dy llogari depozitash speciale, për financimin fillestar të projektit (llogaria speciale A) dhe një për financimin shtesë të projektit (llogaria speciale B), në një bankë me afate dhe kushte të kënaqshme për Shoqatën, duke përfshirë mbrojtjen përkatëse ndaj marrëdhënieve të kompensimit për diferencat, konfiskimit dhe bashkëngjitjeve (atashimeve). Depozitimet në llogaritë speciale dhe pagesat prej tyre do të bëhen në përputhje me parashikimet e ndarjes 5 të kësaj Marrëveshjeje".

Seksioni 1.04 Në klauzolë është shtuar në fund të seksionit 2.04 (b) (i) të Marrëveshjes së kredisë të zhvillimit që lexohet si më poshtë:

"megjithatë, me kusht që taksa e angazhimit mbi financimin shtesë do të rritet duke filluar nga një datë gjashtëdhjetë (60) ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje amendimi."

Seksioni 1.05 Fjala "kredi" në seksionin 2.07 (a) hiqet dhe zëvendësohet me fjalët "Financim Fillestar".

Seksioni 1.06 Seksioni 2.08 kalon seksioni 2.09 dhe shtohet një seksion i ri 2.08 si më poshtë:

"Seksioni 2.08 Huamarrësi do të shlyejë shumën e principalit të financimit shtesë në këste gjashtëmujore, që paguhet çdo 15 prill dhe 15 tetor, duke filluar nga 15 prilli 2013 dhe duke përfunduar në 15 prill 2023. Çdo kështë do të jetë 5% e shumës kryesore."

Seksioni 1.07 Për këtë, ndarja 1 e Marrëveshjes së kredisë të zhvillimit rishikohet siç tregohet në shtojcën I të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 1.08 Përshkrimi i pjesës A të ndarjes 2 të Marrëveshjes së kredisë të zhvillimit ndryshohet si më poshtë:

a) gjatësia e rrugëve kombëtare, që do të riparohen dhe do të mirëmbahen sipas paragrafit 1 të pjesës A të projektit, ndryshon nga "500 km" në "1000 km";

b) gjatësia e rrugëve rurale që do të riparohen dhe do të mirëmbahen sipas paragrafit 2 të pjesës A të projektit ndryshon nga "500 km" në "1000 km".

Seksioni 1.09 Pjesa C e seksionit I të ndarjes 3 të Marrëveshjes së kredisë të zhvillimit ndryshohet si më poshtë:

a) fraza "deri në një shumë totale që të mos e kalojë ekuivalentin prej 9 000 000 \$", në paragrafin 1(a) të pjesës C, hiqet;

b) fraza "deri në një shumë totale që të mos e kalojë ekuivalentin prej 280 000 \$", në paragrafin 2 të pjesës C, hiqet;

c) fraza "deri në një shumë totale që të mos e kalojë ekuivalentin prej 1 200 000 \$", në paragrafin 3 të pjesës C, hiqet.

Seksioni 1.10 Për këtë ndarja 5 e Marrëveshjes së kredisë të zhvillimit rishikohet siç tregohet në shtojcën II të kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 2

### **Data efektive, përfundimi**

Seksioni 2.01 Kjo Marrëveshje amendimi nuk do të hyjë në veprim, derisa Shoqatës t'i paraqiten dëshmi të kënaqshme për të se zbatimi dhe livrimi i kësaj Marrëveshjeje amendimi nga ana e Huamarrësit është autorizuar ose ratifikuar siç duhet nga gjithë veprimet e nevojshme qeveritare.

Seksioni 2.02 Si pjesë e dëshmisë që do të paraqitet në pajtim me seksionin 2.01 të kësaj Marrëveshjeje amendimi, do t'i paraqitet Shoqatës një mendim ose mendime të kënaqshme për këshillin e Shoqatës të pranueshme për performancën e Shoqatës nga ana e Huamarrësit, se kjo Marrëveshje amendimi është autorizuar ose ratifikuar siç duhet, është zbatuar dhe livruar në emër të Huamarrësit dhe është e detyrueshme për Huamarrësin, në përputhje me kushtet e saj.

Seksioni 2.03 Kjo Marrëveshje amendimi do të hyjë në fuqi dhe në veprim në datën që Shoqata do t'i dërgojë Huamarrësit njoftim për pranimin nga ana e saj e dëshmisë që kërkohet nga seksioni 2.01 i kësaj Marrëveshjeje amendimi.

Seksioni 2.04 Nëse kjo Marrëveshje amendimi nuk hyn në fuqi dhe në veprim deri në një datë 90 ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje amendimi, kjo Marrëveshje amendimi dhe të gjitha detyrimet e palëve këtej e tutje do të përfundojnë, nëse Shoqata nuk përcakton një datë të mëvonshme për qëllimet e këtij seksioni. Nëse kjo Marrëveshje amendimi do të përfundojë sipas parashikimeve të këtij seksioni, Marrëveshja e kredisë së zhvillimit do të vazhdojë të jetë plotësisht në fuqi dhe në veprim, sikur kjo Marrëveshje amendimi të mos ishte zbatuar.

Në prani të njëra-tjetrës, Palët në këtë Marrëveshje, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje amendimi me emrat e tyre respektive në Tiranë, Shqipëri, në datën dhe vitin e shkruar më sipër.

SHTOJCA I  
NDARJA I  
TËRHEQJA E SHUMAVE TË KREDISË

1. Tabela më poshtë parashtrohet kategoritë e artikujve që do të financohen nga shumat e kredisë, shpërndarjen e shumave të kredisë për çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për artikujt që do të financohen në çdo kategori:

| Kategoria                                          | Shuma e shpërndarjes së financimit fillestar (e shprehur në SDR) | Shuma e financimit shtesë (e shprehur në SDR) | % e shpenzimeve që do të financohen                                                               |
|----------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1) Punimet                                         | 10 600 000                                                       | 8 412 000                                     | 80%                                                                                               |
| 2) Mallrat                                         |                                                                  |                                               | 100% i shpenzimeve të huaja, 100% i shpenzimeve lokale                                            |
| a) Sipas pjesës B (3) të projektit                 | 200 000                                                          | 73 000                                        | (kostot e ish-fabrikave) dhe 80% të shpenzimeve lokale për artikuj të tjerë që prokurohen në vend |
| b) Sipas pjesëve A,B 1), (2) dhe (4) të projektit  | 400 000                                                          | 145 000                                       | 85%                                                                                               |
| 3) Shërbimi i konsulentëve, trajnimet dhe auditimi | 2 300 000                                                        | 870 000                                       |                                                                                                   |
| Totali                                             | 13 500 000                                                       | 9 500 000                                     |                                                                                                   |

2. Për qëllime të kësaj ndarjeje:

a) termi "shpenzime të huaja" nënkupton shpenzimet në valutën e çdo vendi të ndryshme nga ajo e Huamarrësit për mallra dhe shërbime të furnizuara nga territori i çdo vendi i ndryshëm nga ai i Huamarrësit;

b) termi "shpenzime lokale" nënkupton shpenzimet në monedhën e Huamarrësit ose për mallra a shërbime të furnizuara nga territori i Huamarrësit.

3. Pavarësisht nga parashikimet e paragrafit 1 më sipër, asnjë tërheqje nuk do të bëhet lidhur me pagesat e bëra për shpenzimet para datës së kësaj Marrëveshjeje.

4. Shoqata mund të kërkojë që tërheqet nga llogaria e kredisë të bëhen mbi bazën e deklaramit të shpenzimeve sipas kontratës për: (i) punimet që nuk e kalojnë shumën 100 000 \$; (ii) mallrat që nuk e kalojnë shumën 100 000 \$; (iii) firmat e konsulentëve që nuk e kalojnë shumën 100 000 \$ për konsulentët individualë që nuk e kalojnë shumën 50 000 \$ sipas afateve dhe kushteve të tilla, siç do të specifikohen nga Shoqata në njoftimin për Huamarrësin.

SHTOJCA II  
NDARJA 5  
LLOGARITË SPECIALE

1. Për qëllime të kësaj liste:

a) Termi "kategori të përshtatshme" nënkupton kategoritë (1), (2) dhe (3) të parashtruara në tabelën në paragrafin 1 të ndarjes I në këtë Marrëveshje;

b) Termi "shpenzime të përshtatshme" nënkupton shpenzimet lidhur me koston e arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve që kërkohen për projektin dhe që duhen financuar nga shumat e kredisë së shpërndarë herë pas here në kategoritë e përshtatshme në përputhje me parashikimet e ndarjes 1 të kësaj Marrëveshjeje;

c) Termi "shpërndarje e autorizuar" nënkupton shumën ekuivalente me 1 000 000 \$ lidhur me llogarinë speciale A për financimin fillestar dhe një shumë ekuivalente me 750 000 \$ lidhur me llogarinë speciale B për financimin shtesë që duhet tërhequr nga llogaria e kredisë dhe depozituar në llogaritë speciale, në përputhje me paragrafin 3(a) të kësaj ndarjeje, me kusht që, nëse Shoqata nuk bie dakord ndryshe, shpërndarja e autorizuar do të kufizohet në një shumë ekuivalente me 500 000 \$

lidhur me llogarinë speciale A për financimin fillestar dhe një shumë ekuivalente me 375 000 \$ lidhur me llogarinë speciale B për financimin shtesë deri: (i) lidhur me llogarinë speciale A për financimin fillestar, shuma totale e tërheqjeve nga llogaria e kredisë, plus shumën totale të të gjitha angazhimeve të veçanta të papaguara të ndërmarra nga Shoqata në pajtim me seksionin 5.02 të kushteve të përgjithshme do të jetë e barabartë me ose do të tejkalojë ekuivalentin prej SDR 2 500 000 dhe (ii) lidhur me llogarinë speciale B për financimin shtesë shuma totale e tërheqjeve nga llogaria e kredisë, plus shumën totale të të gjitha angazhimeve të veçanta të papaguara të ndërmarra nga shoqata, në pajtim me seksionin 5.02 të kushteve të përgjithshme, do të jetë e barabartë me ose do të tejkalojë ekuivalentin prej 2 000 000 \$.

2. Pagesat nga llogaritë speciale respektive do të bëhen ekskluzivisht për shpenzimet e përshtatshme në përputhje me parashikimet në këtë ndarje.

3. Pasi Shoqata ka marrë dëshmi të kënaqshme për të se llogaria speciale respektive është hapur siç duhet, tërheqjet e shpërndarjes së autorizuar dhe tërheqjet pasuese për të rimbushur llogarinë speciale do të bëhen si më poshtë:

a) për tërheqjet e shpërndarjes së autorizuar, Huamarrësi do t'i paraqesë Shoqatës një kërkesë ose kërkesa për depozitim në llogarinë speciale respektive, të një shume ose shumave që nuk e tejkalon shumën totale të shpërndarjes së autorizuar. Mbi bazën e një kërkesë a kërkesave të tilla, Shoqata, në emër të Huamarrësit, do të tërheqë nga llogaria e kredisë dhe do të depozitojë në llogarinë speciale respektive një shumë ose shuma të tilla si do ta ketë kërkuar Huamarrësi.

b) (i) Për rimbushjen e llogarisë speciale, Huamarrësi duhet të paraqisë në Shoqatë kërkesën për depozitim në llogarinë speciale në intervale të tilla kohore që do të caktojë Shoqata.

ii) Para ose në kohën e çdo kërkesë të tillë, Huamarrësi do të paraqesë në Shoqatë dokumente dhe evidenca të tjera që kërkojnë në pajtim me paragrafin 4 të kësaj ndarjeje, për pagesën ose pagesat lidhur me të cilat kërkohet rimbushja. Në bazë të çdo kërkesë të tillë, Shoqata, në emër të Huamarrësit, do të tërheqë nga llogaria e kredisë dhe do të depozitojë në llogarinë speciale respektive një shumë të tillë siç do ta ketë Huamarrësi dhe si është treguar në dokumentet e sipërpërmendura dhe evidenca të tjera që janë paguar nga llogaria speciale respektive për shpenzimet e përshtatshme. Të gjitha depozitat e tilla do të tërhiqen nga Shoqata nga llogaria e kredisë dhe në shumat ekuivalente respektive, siç janë justifikuar nga dokumentet e sipërpërmendura dhe evidenca të tjera.

4. Për çdo pagesë të bërë nga Huamarrësi nga llogaria speciale respektive, Huamarrësi, në intervalat kohore të tilla siç do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme Shoqata, do të paraqesë në Shoqata dokumente të tilla dhe evidenca të tjera që tregojnë se pagesa të tilla u bënë ekskluzivisht për shpenzime të përshtatshme.

5. Pavarësisht nga parashikimet e paragrafit 3 të kësaj ndarjeje, Shoqata nuk do të kërkojë të bëjë depozitime të mëtejshme në ndonjë llogari speciale:

a) në qoftë se në një kohë të caktuar, Shoqata do të ketë vendosur se duhen bërë tërheqje të mëtejshme nga Huamarrësi drejtpërdrejt nga llogaria e kredisë në përputhje me parashikimet në nenin 5 të kushteve të përgjithshme dhe paragrafit (a) të seksionit 2.02 të kësaj Marrëveshjeje;

b) në qoftë se Huamarrësi nuk do të arrijë të paraqesë në Shoqatë, brenda periudhës kohore të specifikuar në seksionin 4.01 (b) (ii) të kësaj Marrëveshjeje, secilin nga raportet e auditimit që duhet të paraqitet në Shoqatë në përputhje me seksionin e sipërpërmendur, lidhur me auditimin e të dhënave dhe llogarive për llogaritë speciale;

c) në qoftë se në një kohë të caktuar, Shoqata do të ketë njoftuar Huamarrësin për synimet e tij për të pezulluar tërësisht ose pjesërisht të drejtën e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga llogaria e kredisë në përputhje me parashikimet e seksionit 6.02 të kushteve të përgjithshme;

d) sapo shuma totale e pa tërhequr e Kredisë së shpërndarë në kategoritë e përshtatshme për llogaritë speciale respektive, minus shumën totale të të gjitha angazhimeve të papaguara të ndërmarra nga Shoqata, në përputhje me seksion 5.02 të kushteve të përgjithshme lidhur me projektin, do të barazohen me ekuivalentin e dyfishit të shumës së shpërndarjes së autorizuar.

Pas kësaj, tërheqja nga llogaria e kredisë e shumës së mbetur të pa tërhequr që është shpërndarë në kategoritë e përshtatshme do të ndjekë procedura të tilla që do të specifikohen nga Shoqata duke njoftuar Huamarrësin. Tërheqje të tilla të mëtejshme do të bëhen vetëm pasi dhe në atë masë që do të kënaqin Shoqatën se të gjitha shumat e mbetura në depozitë në llogarinë speciale respektive deri në datën e njoftimit do të shfrytëzohet për bërjen e pagesave për shpenzimet e përshtatshme.

6.a) Në qoftë se Shoqata do të ketë vendosur në çdo kohë që ndonjë pagesë nga llogaria speciale: (i) u bë për një shpenzim ose në një shumë jo të përshtatshme në përputhje me paragrafin 2 të kësaj ndarjeje; (ii) nuk u justifikua me evidenca të paraqitura në Shoqatë, Huamarrësi, menjëherë pas njoftimit nga Shoqata do të (A) sigurojë një evidencë të tillë shtesë siç mund të kërkojë Shoqata ose (B) do të depozitojë në llogarinë speciale respektive (ose nëse Shoqata do të kërkojë këtë, të kthejë të hollat) një shumë të barabartë me shumën e pagesës së tillë ose pjesën e saj jo të përshtatshme dhe të justifikuar. Nëse Shoqata nuk bie dakord ndryshe, nuk do të bëhen depozitime të mëtejshme nga Shoqata deri sa Huamarrësi të ketë siguruar evidencë të tillë ose ka bërë një depozitim ose kthim të hollash në çdo llogari speciale respektive, si të paraqitet rasti.

b) Në qoftë se Shoqata do të ketë vendosur në çdo kohë që ndonjë shumë e papaguar në çdo llogari speciale nuk do të kërkohej të mbulojë pagesa të mëtejshme për shpenzime të përshtatshme, Huamarrësi, menjëherë pas njoftimit nga Shoqata, do t'i kthejë Shoqatës shumën e papaguar.

c) Huamarrësi, me marrjen e njoftimit nga Shoqata, mund t'i kthejë Shoqatës të gjithë ose ndonjë pjesë të fondeve në depozitë në llogaritë speciale.

d) Kthimi i të hollave Shoqatës, që bëhet në pajtim me paragrafët 6(a), (b) dhe (c) të kësaj ndarjeje, do të kreditohen në llogarinë e kredisë për tërheqjet pasuese ose për anulimin në përputhje me parashikimet përkatëse të kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë kushtet e përgjithshme.

**VENDIM**  
**Nr.743, datë 6.11.2003**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.159, DATË 13.3.2003 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE "PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE QË**  
**PRIVATIZOHET, SI DHE PROCEDURA E SHITJES"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë dhe veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", i ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në kapitullin III "Procedurat e shitjes së pronës shtetërore" të vendimit nr.159, datë 13.3.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 12 shfuqizohet;

2. Fjalja e parë e pikës 13, ndryshohet si më poshtë vijon:

"Procedurat për rastet e parashikuara në pikat 9, 10 dhe 11 të fillojnë me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

**KËRKESË**

Shtetësja Majlinda Koçi(Veizi), e datëlindjes 1973, kërkon të shpallet i zhdukur bashkëshorti Qemal Xhelal Veizi, i datëlindjes 18.3.1966.

**KËRKUESE**  
**Majlinda Koçi (Veizi)**

**Fletorja Zyrtare gjendet:**

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
  - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

**LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI TETOR 2003**

|     |                                                       |      |
|-----|-------------------------------------------------------|------|
| 1.  | KUSHTETUTA                                            | 600  |
| 2.  | PËRMBLEDHËSE NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK            | 1000 |
| 3.  | KODI I PROCEDURËS CIVILE                              | 500  |
| 4.  | KODI I PROCEDURËS PENALE                              | 600  |
| 5.  | KODI PENAL                                            | 400  |
| 6.  | KODI I PUNËS                                          | 500  |
| 7.  | KODI I FAMILJES                                       | 450  |
| 8.  | KODI CIVIL                                            | 1000 |
| 9.  | KODI RRUGOR                                           | 900  |
| 10. | KODI ZGJEDHOR                                         | 355  |
| 11. | PËRMBLEDHËSE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT | 800  |
| 12. | DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT DOGANOR                   | 1500 |
| 13. | DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR                    | 1500 |

Doli nga shtypi më 14.11.2003

|                    |                  |
|--------------------|------------------|
| Tirazhi: 4300 copë | Formati: 60x88/8 |
|--------------------|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2003

Çmimi: 100 lekë